



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

NJOFTIM

MBI AFATET DHE PROCEDURAT E KONKURRIMIT TË PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT
PSIKOSOCIAL PËR VITIN 2026

Në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 313, datë 20.10.2020, i ndryshuar, "Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet arsimore parauniversitare dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit të punonjësit", më poshtë paraqiten afatet, veprimtaritë dhe institucionet përgjegjëse për procedurën e konkurrimit të kandidatëve për shërbimin psikosocial:

Afatet dhe Kalendari i Zhvillimit të Procedurave të Konkurrimit

Nr	Veprimtaria	Afati	Përgjegjës
1	Njoftimi për fillimin e procedurave të konkurrimit për SHPS	18.06.2026	AKAP/DRAP
2	Dërgimi i dosjeve me postë nga kandidatët	18.06.2026- 26.06.2026	DRAP
3	Vlerësimi i dosjeve dhe shpallja e listës paraprake	29.06.2026- 30.06.2026	AKAP/DRAP
4	Afati për ankimimet	01.07.2026- 02.07.2026	DRAP
5	Shqyrtimi i ankimimeve dhe shpallja e listës përfundimtare me pikët e dosjes	01.07.2026- 02.07.2026	AKAP/DRAP
6	Testimi me shkrim	06.07.2026	AKAP/DRAP
7	Vlerësimi i testeve dhe shpallja e listës së kandidatëve të kualifikuar me pikët e dosjes dhe testimit	07.07.2026- 08.07.2026	AKAP/DRAP
8	Afati i ankimimeve për testimin me shkrim dhe shqyrtimi i ankesave	09.07.2026- 10.07.2026	AKAP/DRAP
9	Intervista e strukturuar	13.07.2026- 14.07.2026	AKAP/DRAP
10	Shpallja e listës përfundimtare sipas renditjes	15.07.2026	AKAP/DRAP

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Jetëshkrimi (Curriculum Vitae).
2. Kërkesë për lëvizje paralele.
3. Raport mjekoligjor i lëshuar brenda tre muajve të fundit.
4. Kopje e diplomës/diplomave dhe dokumentet e njohjes sipas rastit.
5. Lista e notave për nivelin Bachelor dhe Master.
6. Licenca për ushtrimin e profesionit.
7. Deklaratë për verifikimin e dokumenteve.
8. Formulari i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore.
9. Dokumente të arsimit shtesë dhe kualifikimeve.
10. Fotokopje e noterizuar e librezës së punës.
11. Fotokopje e kartës së identitetit ose certifikatë personale.
12. Dëshmi penaliteti.

DREJTOR
Zaira Gjika